

Ministri Halimi prezantoi nismat më të fundit të dikasterit të tij, disa ndryshime ligjore ne "Kodin e Procedurës Civile" dhe "Kodin Civil", si pjese e rëndësishme e reformës në drejtësi, gjatë një takimi që zhvilloi me grupet e interesit, ne 28.01.2013, në Tiranë. Duke prezantuar paketën e re ligjore, ministri Halimi tha se vijmë sot me një pakete, e cila ka në fokus efencën e sistemit gjyqësor dhe lehtësimin e procedurave për qytetarët.

Paketa e re e ndryshimeve, ka të bëjë me:

1- Heqjen e trajtimit të dëshmisë së trashëgimisë nga gjykatat dhe kalimin e këtij procesi tek noteri, duke eliminuar procedurat gjyqësore për dëshmitë e trashëgimisë. Nëpërmjet sistemit të ri të noterisë, qytetari vetëm brenda pak minutave mund ta marrë këtë shërbim shumë më shpejt. Kjo reformë ka rëndësi edhe për sistemin gjyqësor, sepse do të lehtësoje punën e gjyqtarëve dhe do të rrisë cilësinë profesionale të punës së tyre.

Një qytetari sot i duhet të kryejë të paktën **5 hapa** për të kërkuar të marrë një vendim gjyqësor për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, të harxhojë të paktën 200-300 euro dhe të paktën 1 muaj kohë për këtë proces. Kjo situatë duhet të ndryshohet.

Ne propozojmë që **këto vendime gjyqësore të hiqen nga procedurat gjyqësore** dhe t'i kalojnë noterit. Nëpërmjet sistemit të ri të noterisë, qytetari mund ta marrë këtë shërbim shumë më shpejt vetëm brenda pak minutave dhe me kosto shumë me të ulët.

2- Edhe procesi i lëshimit të urdhërave të ekzekutimit duhet të reformohet dhe ne sot kemi paraqitur një skemë e cila do të eliminojë **automatikisht** gjithë këtë ngarkesë të jashtëzakonshme për qytetarët dhe gjyqtarët. Këto reforma sjellin efencë të sistemit gjyqësor, pasi më tepër se 25.000 çështje të tilla nuk do të jenë më në proces.

Qytetarët do të përfitojnë kohë. Sot qytetarët ndjekin edhe 4 hapa për të marrë Urdherin e ekzekutimit pas jrrreth 2-3 vitesh minimumi neper shkallet e gjykatave. Pas ka mbaruar gjykimet gjyqësues nuk mbaron historite e me gjykatat sepse serish i duhen tre hapa, minimalisht 3 dite serish ne gjykate, nje dite per te paraqitur kerkesen, nje dite per shortin, nje dite per gjyqin dhe nje dite per te marre vendimin e zbardhur te gjyqit. Me kete skeme ne heqim totalisht kete sorollatje te qytetareve, teresisht te panevojshme. I falim qytetareve ate qe eshte me rendesishme, kohen, por i falim dhe burokracite dhe lodhjen dhe i kursejme parate. Urdherat e ekzekutimit dalin menjehere pas daljes se vendimit, pa qene nevoja e ndonje kerkese te paes, dhe eshte sekretaria e gjykatates ajo qe leshon kopjen e urdherit kur ai kthehet ne titull.

3 – Digitalizimi i sistemit gjyqësor duhet të gjeje edhe me shume hapësire ne proceset gjyqësore. **Mosnjoftimi i palëve në një proces gjyqësor,** përbën shkelje të rëndë të normave procedurale mbi rregullshmërinë e njoftimeve, si mjet që garanton të drejtën kushtetuese për t'u vënë në dijeni dhe mundësuar dëgjimin nga gjykata të personit që gjendet në pozitën e palës ndërgjyqëse në një proces gjyqësor përpara dhënies së një vendimi. **Mënyra dhe procedurat e njoftimit do të realizohen nëpërmjet përfshirjes së metodave të reja të komunikimeve elektronike, nëpërmjet telefonisë së lëvizshme (celular) ose nëpërmjet postës elektronike, të cilat do të jenë gjithashtu pjesë e kësaj pakete.**

Me kete pakete ne i japim mundesine qytetareve te marrin njoftim per cdo seance, me nje sms, per ate qe kaloi dhe per ate vjen, duke eliminuar proceduren e shtyrjes se gjykimeve per shkak mosnjoftimi.

Kalendari elektronik i gjyqtareve duhet te jete pjese e punes se cdo gjyqtari, duke mos i dhene mundesi asnje pale te shtyje proceset pasi njoftimin duhet ta marrin kohe me pare dhe konsultohen me te 24 ore ne 24.

3- Reforma e Gjykates se Larte, do te sjelle edhe gjykimin ne kete gjykate me tre gjyqtare dhe jo me 5, ceshtjet qe ne shkalle te pare gjykohen me 1 gjyqtar, dhe po keshtu filtri i ceshtjeve qe do te shkojne ne Gjykatën e Larte do te kete tendence mbyllje. Keto ndryshime do te sjelin nje eficence me te madhe te gjykimit ne kete shkalle gjykimi si dhe do ti jape mundesi krijimit te disa trupave gjyqesore duke shpejtuar gjykimin. Kjo pjese e paketes don te sjelle jo vetem impakt per qytetaret per te shpejtuar proceset, por edhe per gjykatën.

4- Po keshtu, kjo pakete vjen edhe si kerkese e Shoqates se Bankave, për të ndaluar dhe ulur masën e kredive me probleme nga njera ane dhe rritja e efektivitetit të ekzekutimit të kolateralit nga ana tjetër. Reforma ne KPC është **mekanizmi kryesor procedural për zbatimin e kredive me probleme.** Me qëllim përshpejtimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, për të lehtësuar procedurat, gjykata me anë të ndryshimeve të propozuara, mund të pezullojë ekzekutimin me anë të një mase parandaluese të urdhëruar në padi.

- Ne favor te sistemin bankar, reformohet **procesi i ekzekutimit te kolateralit, duke ulur dyshemene e kolateralit nga 65% ne 50%**, bazuar kjo edhe ne modelet e vendeve te BE.

- Reformohet **procedura e ekzekutimit te titujve** ne sistemin gjyqesor, problemet me te cilat bankat jane ndeshur jo pak keto vite perfshi ketu procesin e pezullimit te ketyre kredive, pa asnje shkak dhe pa asnje garanci. Pak kohe me vone ne do inagurojme **nje portal te ri per sistemin bankar** dhe aksesin ne ZRPP dhe Sherbimin Permbarimor, ku per cdo prone kolateral dhe per cdo titul ekzkeutiv, bankat do te pajisen me nje sistem Alarmi, duke patur akses online por dhe duke u informuar 24 ore ne 24 per cdo problem me pasurite e tyre si kolateral dhe ato ne ekzkutim. Ky do te jete **portali unik ne rajon dhe me gjere**, qe u jep kaq shume akses bankave, te bindur se rruajtja e stabilitet bankar eshte jashtezakonisht i lidhur me sistemin funanaciar dhe imunitetet nga kriza financiare boterore.

Të gjitha këto ndryshime të propozuara, të nderuar pjesmarrës, shkojnë në drejtim të një reformimi të rëndësishëm të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Unë besoj se këto reforma së bashku me ngushtimin e filtrit të çështjeve që shkojnë në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, në përputhje me Planin e Veprimit për realizimin e 12 Rekomandimeve të Bashkimit Europian, janë çështje që do të sjellin pritshmëri të jashtëzakonshme **drejtim të kolonës së eficencës** se sistemit te drejtesise dhe do të japin një **impakt pozitiv** në të gjithë korpusin e sistemit gjyqësor.

Reforma ne drejtesi nuk eshte nje reforme qe fillon dhe mbaron. Tre ligje presin ne kuvend per tu miratuar, njeri prej tyre jetik per reformen ne drejtesi. **Pas disa javesh do te jene dhe dy ligje te tjera qe ne prezantojme sot.**

Këto janë reforma **që i interesojnë së pari qytetarëve dhe nuk janë reforma që krijojnë favore politike. Qytetarët paguajnë taksa**, para të fëmijëve të tyre, që ne të hartojmë studime, të hartojmë ligje dhe të reformojmë sistemet, por dhe ti votojme keto ligje. Ne rast se ne **nuk i votojme nuk kemi arsye tu dalim perpara** dhe jo me ti kerkojme te na votojne serish. Kjo eshte llogjike fare e thjeshte dhe qytetaret shqiptare e kuptojne fare mire.

Une shpresoj qe kjo pakete qe do propozohet pasi te merren mendimet tuaja dhe te qytetarev ne javet ne vijim, te mos jete peng i opozites ne parlament, **por qe ajo dhe deputetet te ngrihen ne pergjegjesite e tyre politike, para qytareve per ti votuar ne parlament ne respekt te qytetareve qe i kane votuar. Une i kam ftuar ata sot ne kete tryeze, pamvarsisht se nuk kane ardhur. Draftin do e kene ne faen e internetit dhe kane gjithë kohen e duhur per te bere cdo verejtje dhe cdo sugjerim.**

Së fundi, do doja tu falenderoja të gjithëve që gjetët kohën të merrni pjesë në këtë takim konsultativ, dhe më lejoni t'ju siguroj për vendosmërinë e Ministrisë së Drejtësisë për të qenë të hapur për sugjerime dhe shkëmbime idesh mbi këto çështje dhe mbi reformën në drejtësi, sot dhe në ditët në vijim. Te gjitha propozimet do te trajtohen me keshilltaret tane qe kemi fatin ti kemi ne MD, Misionin Euralius per ti standartizuar me modelete europiane dhe per ti paraqitur me pas ne Kuvend.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**



PROJEKT

LIGJ

Nr.____, datë __.__.____

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7850, DATË 29.7.1994 “KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 333, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Heqja dorë nga trashëgimi duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet tek noteri ku është çelur trashëgimi, ose me gojë në një procesverbal të mbajtur nga noteri”.

Neni 2

Në nenin 336, togfjalëshi “gjykata e rrethit ku është çelur trashëgimia” zëvendësohet me togfjalëshin “noteri tek i cili është çelur trashëgimia”.

Neni 3

Neni 348 ndryshon si vijon:

“Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgim caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe ligjin për noterinë”.

Neni 4

Në nenin 546 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Dispozitat për pengun nuk zbatohen në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë”.

Neni 5

Kreu XIII, i Titullit II, të Pjesës V ndryshon si vijon:

“KREU XIII

AGJENCIA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 950

Me kontratën e agjencisë, njëra palë, në cilësinë e ndjermjetësit të vetëpunësuar, ka në mënyrë të vazhdueshme autoritetin që të negociojë shitjen apo blerjen e mallrave për një palë tjetër, porositësit, apo të negociojë dhe të përfundojë këto transaksione në emër dhe për interes të porositësit.

Secila palë, me kërkesë, ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një dokument të nënshkruar që përmban kushtet e kontratës së agjencisë, përfshirë edhe klauzola të mëvonshme shtesë. Nga kjo e drejtë nuk mund të hiqet dorë.

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe kur pala porositëse i jep agjentit të drejtën e përfaqësimit për lidhjen e kontratave.

Neni 951

Ekskluziviteti

Pala porositëse nuk mund të pajtojë njëkohësisht më shumë se një agjent në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të drejtën fushë të veprimtarisë, dhe po ashtu, as agjenti nuk mund të marrë përsipër njëkohësisht të trajtojë në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë kontratat e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Agjenti tregtar, në ushtrimin e aktiviteteve të tij, duhet të kujdeset për interesat e porositësit dhe të veprojë me besnikëri dhe në mirëbesim.

1. Agjenti tregtar duhet në veçanti:

a) Të përpiket për të negociuar dhe kur është rasti, të përfundojë transaksionet për të cilat është ngarkuar;

b) T'i njoftojë porositësit cdo informacion të nevojshëm që ai disponon;

c) Të zbatojë udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga porositësi

Porositësi, në marrëdhëniet e tij me agjentin tregtar, duhet të veprojë me besnikëri dhe mirëbesim.

2. Porositësi duhet në veçanti:

a) Të vërë në dispozicion të agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me mallrat në fjalë;

b) T'i sigurojë agjentit tregtar informacionet e nevojshme për përmbushjen e kontratës së agjencisë, vecanërisht të njoftojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm sapo ai parashikon që volumi i veprimeve tregtare do të jetë në mënyrë të dukshme më i ulët se ai të cilin agjenti tregtar do të priste normalisht.

Porositësi, vec kësaj, duhet të informojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, për pranimin, refuzimin ose mosekzekutimin e një transaksioni që agjenti tregtar ka siguruar për porositësin.

Palët nuk mund të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 953

Pagesa e agjentit tregtar

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e komisionit që agjentët tregtare, të caktuar për mallrat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, lejohen zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtë për një shpërblim të arsyeshëm duke patur parasysh të gjitha aspektet e transaksionit.

Konsiderohen si komision të gjithë elementët e pagesës që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare.

Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një pagese të arsyeshme që merr parasysh të gjithë elementët që kanë të bëjë me veprimin.

Neni 954

1. Agjenti tregtar ka të drejtën e komisionit për transaksionet tregtare të përfunduar gjatë periudhës së kontratës së agjencisë,

- a) Nëse transaksioni është përfunduar si rezultat i veprimit të tij;
- b) Nëse transaksioni është përfunduar me një të tretë të cilin ai kishte fituar më parë si klient për transaksione të të njëjtit lloj.
- c) Nëse ai ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike të caktuar ose një grupi klientësh dhe transaksioni është kryer me një klient që i përket kësaj zone këtij grupi.

2. Për një transaksion të përfunduar pas përfundimit të kontratës së agjencisë, agjenti tregtar ka të drejtën e komisionit:

a) Nëse transaksioni i detyrohet kryesisht përpjekjeve të tij të kryera gjatë kontratës së agjencisë dhe nëse transaksioni përfundoi në një afat kohor të aryeshëm pas përfundimit të kontratës; ose

b) Nëse urdhri i një të treti ka qënë marrë nga porositësi ose nga agjenti tregtar para përfundimit të kontratës së agjencisë

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e komisionit nëse ky komision i detyrohet agjentit tregtar paraardhës, përveç kur nuk rezulton nga rrethanat që është e drejtë që komisioni të ndahet mes agjentëve tregtare.

Komisioni bëhet i pagueshëm në momentin dhe në masën kur paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme :

a) Pala porositëse ka ekzekutuar transaksionin;

b) Pala porositëse duhej të kishte ekzekutuar transaksionin në përputhje me marrëveshjen e përfunduar me palën e tretë;

c) Pala e tretë ka ekzekutuar transaksionin.

Komisioni merret më vonë kur një i tretë ka ekzekutuar pjesën e tij të transaksionit apo do të duhej ta kishte ekzekutuar nëse pala porositëse kishte ekzekutuar pjesën e tij të transaksionit. Komisioni paguhet jo më vonë se dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit në të cilin bëhet i pagueshëm.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i paragrafëve 5 dhe 6 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 955

E drejta për komision mund të shuhet vetëm nëqoftëse dhe në masën në të cilën:

a) Vendoset se kontrata ndërmjet të tretit dhe porositësit nuk do të ekzekutohet, dhe

b) Mos ekzekutimi nuk i detyrohet rrethanave që i ngarkohen porositësit.

Komisionet që agjenti tregtar ka marrë tashmë kthehen nëse e drejta për to shuhet.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i paragrafëve 1 dhe 2 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 956

Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të komisioneve që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit në të cilin bëhet i pagueshëm. Ekstrakt

Ilogaria duhet të tregojë elementët thelbësore në bazë të të cilave është kryer përlllogaritja e komisioneve.

Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet në vecanti një ekstrakt i librave kontabël, që janë në dispozicion të porositësit, të nevojshme për të verifikuar shumën e komisioneve të paguara.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i paragrafëve 1 dhe 2 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 957

Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës së agjencisë

Kontrata e agjencisë me kohë të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të kohës, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Po që se kontrata e agjencisë është me kohë të pacaktuar secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati të caktuar.

Afati i njoftimit paraprak nuk mundet, të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, 4 muaj për vitin e katërt, 5 muaj për vitin e pestë dhe gjashtë muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjithë vitet në vazhdim. Nëse palët merren vesh për afate paralajmërimi më të gjata. Afati i paralajmërimit që duhet të respektojë pala porositëse nuk duhet të jetë më i shkurtër se afati që duhet të respektojë agjenti. Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të paralajmërimit duhet të përkohë me ditën e fundit të muajit kalendarik. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe për kontratën e agjencisë me kohë të përcaktuar të shndërruar në kontratë me kohë të papërcaktuar, me kushtin që në llogaritjen e afatit të paralajmërimit duhet të mbahet parasysh afati i mëparshëm.

Në përfundim të marrëveshjes së agjencisë, porositësi detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim nëse dhe në masën dhe kur:

a) Agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm marrëveshjet me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga marrëveshjet me këta klientë;

b) Pagesa e këtij shpërblimi është e drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sidomos komisionet që agjenti tregtar humbet dhe që rezultojnë nga veprimet me këta klientë, si dhe nga kufizimi i aktiviteteve të tij profesionale që i deyrohen ekzistencës në një klauzole të mos konkurrencës.

Shuma shpërblimit nuk mund të tejkalojë një shifër të barabartë më një shpërblim vjetor të llogaritur nga mesatarja vjetore të shpërblimeve të marra nga agjenti tregtar gjatë pesë viteve të fundit dhe po që se kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e periudhës në fjalë. Dhënia e shpërblimit nuk privon agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti tregtar ka të drejtë për shpërblimin e dëmit që ka pësuar si rezultat i përfundimit të marrëdhënieve me palën porositëse.

Ky dëm rezulton vecanërisht kur përfundimi i kontratës ka ndodhur në kushte:

- Të cilat privojnë agjentin tregtar nga komisioni që mund të kishte fituar me përmbushjen në mënyrën e duhur të kontratës, duke i siguruar në të njëjtën kohë porositësit përfitime të konsiderueshme të lidhura me aktivitetin e agjentit tregtar;

- Dhe/ose nuk kanë mundësuar agjentin që të amortizojë kostot dhe shpenzimet që ka pësuar për përmbushjen e kontratës sipas udhëzimeve të porositësit.

E drejta për shpërblim lind gjithashtu edhe kur kontrata e agjencisë përfundon si rezultat i vdekjes së agjentit tregtar. Agjenti tregtar humbet të drejtën për shpërblim nëse brenda një viti nga përfundimi i kontratës, nuk i komunikon porositësit qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tij.

Neni 958

Nuk paguhet shpërblim kur:

- a. Pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila justifikon një zgjidhje të menjëhershme të kontratës;
- b. Agjenti përfundon kontratën, përveç rastit kur përfundimi justifikohet nga rrethanat që i atribuohen porositësit, ose për shkak të moshës, paaftësisë ose sëmundjes së agjentit tregtar, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;
- c. Sipas një marrëveshjeje me palën porositëse, agjenti i jep një pale të tretë të drejtat dhe detyrimet që ai ka në bazë të kontratës së agjencisë.

Neni 959

Palët nuk mund të shamngin, para skadimit të kontratës, zbatimin e neneve 957-958 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 960

Marrëveshja që parashikon një kufizim të aktiviteteve profesionale të agjentit tregtar pas përfundimit të kontratës quhet klauzole e mos konkurrencës.

Marrëveshja e mos konkurrencës është e vlefshme kur bëhet me shkrim. Ajo duhet t'i përkasë një zone gjeografike ose grupi të klientëve dhe zonën gjeografike të besuar agjentit tregtar si dhe llojin e mallrave për të cilat agjenti tregtar kishte përfaqësimin sipas kontratës.

Klauzola e mos konkurrencës është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 2 vjet nga dita e përfundimit të kontratës.

Neni 961

Klauzola kontraktore *del credere*

Një marrëveshje me anë të së cilës agjenti garanton që një klient do të paguajë cmimin e mallrave që përbëjnë objektin e kontratës të cilën e ka negociuar apo përfunduar agjenti (*klauzola del credere*) është e vlefshme vetëm nëse dhe për aq sa ajo është bërë me shkrim, mbulon vetëm kontratat e specifikuara shprehimisht në marrëveshje dhe është e arsyeshme për sa i përket interesave të palëve sidomos për sa i përket shumës së komisionit *del credere* për të cilën agjenti ka të drejtë.”

Neni 6

Dispozite tranzitore

Këto dispozita janë të zbatueshme për marrëveshjet e agjencive të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ato janë të zbatueshme për marrëveshjet e agjencisë të lidhura përpara kësaj date duke filluar nga data __/__/__, ndërsa deri atëherë këto marrëveshje do rregullohen nga Kodi Civil sic është në fuqi përpara këtyre ndryshimeve.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**



PROJEKT

LIGJ

Nr.____, datë __.__.____

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996 “KODI I
PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Në nenin 77, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal. Procesverbali përshkruan fjalë për fjalë veprimet e kryera në seancë, me mjete teknike dhe vetëm kur këto mungojnë, me shtypshkrim apo dorëshkrim”.

Neni 2

Neni 118 ndryshohet si vijon:

“Neni 118

Për seancën gjyqësore dhe për çdo veprim gjyqësor të kryer jashtë seancës mbahet procesverbal, i cili përshkruan veprimet e kryera në seancë dhe pasqyron fjalë për fjalë kërkimet

dhe kundërshtimet e palëve dhe të personave të tretë, thëniet e dëshmitarëve dhe të ekspertëve, provat me shkresë që janë paraqitur, përmbajtjen e shiritave të magnetofonit, të diapozitivave, të filmave, të gjitha vendimet që ka dhënë gjykata në vazhdim të gjykimit, si dhe pretendimet përfundimtare të palëve dhe, në mënyrë të përmbledhur, kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim. Në të tregohen:

- a) vendi (emri i qytetit, i qendrës së banimit ose i vendit tjetër);
- b) koha kur gjykohet çështja ose kur kryhet veprimi gjyqësor;
- c) përbërja e trupit gjykues (emir dhe mbiemri i gjyqtarëve dhe i sekretarit).

Gjithashtu, në procesverbal duhet të shënohen edhe personat që janë thirrur në seancën gjyqësore dhe cilët nuk janë paraqitur.

Kur procesverbali mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim secila nga palët ka të drejtë të kërkojë që të shënohen në procesverbal pjesë nga thëniet e palës tjetër dhe gjykata duhet ta marrë parasysh këtë kërkesë.

Në rast se procesverbali është mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim, menjëherë pas mbylljes së seancës, ai nënshkruhet në fund të çdo flete nga kryetari i seancës gjyqësore dhe sekretari dhe përfshihet në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor.

Regjistrimi i plotë origjinal ruhet në serverin e gjykatës për aq kohë sa ruhet edhe dosja e çështjes”.

Neni 3

Pas nenit 128, shtohet neni 128/1, me përmbajtje si vijon:

“Neni 128/1

Përveç rastit të parashikuar në nenin 128, thirrja në gjykatë bëhet edhe me mjete të ndryshme komunikimi, si adresë elektronike, thirrjeve telefonike apo nëpërmjet një mesazhi të shkruar në telefon, nëpërmjet sistemit të njoftimit elektronik, të krijuar për këtë qëllim”.

Neni 4

Neni 130 ndryshohet si vijon:

“Neni 130

Rregullat e njoftimit të akteve

Njoftimi, nëpërmjet letërthirrjes bëhet nëpërmjet dorëzimit nga nëpunësi gjyqësor të kopjes së aktit që duhet t’i njoftohet personit që përcaktohet si marrës, kudo që gjendet brenda territorit të juridiksionit të gjykatës, ku është në marrëdhënie pune nëpunësi gjyqësor”.

Neni 5

Pas nenit 130 shtohen nenet 130/1 dhe 130/2, me përmbajtje si vijon:

“Neni 130/1

Njoftimi i palëve ose përfaqësuesve të tyre, nëpërmjet thirrjeve telefonike apo nëpërmjet një mesazhi të shkruar në telefon, bëhet nga punonjësit e gjykatës nëpërmjet sistemit të njoftimit elektronik. Këto njoftime kryen në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike.

Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen numri i telefonit në të cilin bëhet njoftimi, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon nëpunësi gjyqësor dhe qëllimi i njoftimit.

Procesverbali i këtij komunikimi hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe nëpunësit gjyqësor të ngarkuar me kryerjen e njoftimeve. Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes së gjykimit.

Neni 130/2

Njoftimi i palëve ose përfaqësuesve të tyre, në një adresë elektronike, bëhet nga punonjësit e gjykatës nëpërmjet sistemit të njoftimit elektronik. Këto njoftime kryen në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike.

Njoftimi në rrugë elektronike bëhet në formë elektronike në bazë të të dhënave të deklaruara nga palët në padi”.

Neni 6

Neni 141 ndryshohet si vijon:

“Neni 141

Njoftimi për personat juridikë

Njoftimet për institucionet, ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes zyrës së titullarit dhe personave të ngarkuar për të pranuar akte.

Njoftimi për personat juridikë joshtetërorë duhen bërë nëpërmjet e-mailit.

Neni 7

Neni 154 ndryshohet si vijon:

“Neni 154

Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

- gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;

- emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë; adresën elektronike, numër telefoni celular;

- përcaktimin e objektit të kërkesëpadisë;

- tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia;

- kërkimin e paditësit;

- vleftën e padisë, në rast se objekti i saj është i vlerësueshëm”.

Neni 8

Neni 172 ndryshohet si vijon:

“Neni 172

Shqyrtimi i çështjes përpara gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen fashikullit të gjykatës ose procesverbalit kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Në seancë gjyqësore mbahet procesverbal në të cilin pasqyrohen fjalë për fjalë shpjegimet e palëve, provat që merren, si dhe vendimet e urdhrat që shpall gjykata dhe, në mënyrë të përmbledhur, kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim”.

Neni 9

Në nenin 206, shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“b. nëpërmjet masave të tjera të marra nga gjykata, përveç kundërshtimit ndaj veprimeve të përmbauesit, ndaj të cilit nuk mund të merren masa për sigurimin e padisë”.

Neni 10

Pas nenit 299, shtohet neni 299/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 299/a

Njoftimi i pushimit të gjykimit

Gjykata njofton palët në gjykim për pushimin e gjykimit brenda tre ditëve nga marrja e tij”.

Neni 11

Në nenin 310, pas pikës 1 të paragrafit III, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.”

Neni 12

Në fund të nenit 451/a shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vendimi që ka marrë formë të prerë dhe për të cilin duhet lëshuar urdhri i ekzekutimit, kurdoherë shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit, kopja e të cilit, në të njëjtën kohë, u njoftohet palëve së bashku me vendimin e formës së prerë sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod”.

Neni 13

Në nenin 472, shkronja “c”, e paragrafit të parë, shfuqizohet.

Neni 14

Neni 480 ndryshohet si vijon:

“Neni 480

Mospranimi i rekursit

1. Rekursi nuk shqyrtohet në themel në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe në përputhje me kushtet procedurale;

2. Mospranimi i rekursit vendoset nga trupi gjykues me tre gjyqtarë në mungesë të palëve, pasi janë marrë pretendimet me shkrim të palëve për çështjen e pranueshmërisë. I njëjti trup gjykues vendos për çdo kërkesë procedurale pa prekur themelin e çështjes.

Neni 15

Paragrafi i parë i nenit 482 ndryshohet si vijon:

“1. Gjkata e Lartë shqyrton çështjet në themel me trup gjykues me pesë gjyqtarë, përveç çështjeve të parashikuara në nenin 35 të këtij kodi për t’u gjykuar nga një gjyqtar, të cilat Gjykata e Lartë i shqyrton me trup gjykues me tre gjyqtarë”.

Neni 16

Në nenin 497 togfjalëshi “Gjykatës së Lartë”, zëvendësohet me “Gjykatës së Apelit në të cilën vendimi ka marrë formën e prerë”.

Neni 17

Në nenin 498, bëhen këto ndryshime:

- a) Titulli bëhet: “Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Apelit”.
- b) Fjalët “Gjykata e Lartë” zëvendësohen me fjalët “Gjykata e Apelit”.

Neni 18

Në nenin 511, bëhen këto ndryshime:

- a) Paragrafi i parë riformulohet si vijon:
“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim, sipas urdhrit të ekzekutimit i cili jepet:”
- b) Pika ç riformulohet si vijon:
“ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d” , “dh” dhe “e” brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, nga gjykata e vendit ku është caktuar të bëhet ekzekutimi”.

Neni 19

Në nenin 517, paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

“Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjëndjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt i dhënies së kredisë bankare”.

Neni 20

Në nenin 577, paragrafi i parë, ndryshohet si vijon:

“Në rast së në ankandin e parë nuk është paraqitur anjë ofrues, atëhere, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij përmbaruesi gjyqësor cakton çmimin e ri të sendit, i cili ulet në 50% të vlerës aktuale të sendit. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të cmimit të ri”.

Neni 21

Në nenin 611, në paragrafin e parë, hiqet shpreja “përveç kur gjykata vendos ndryshe”.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.